

NOTË INFORMATIVE

Tiranë, më 13.03.2024

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “shkarkim nga detyra” për magjistratin H.S.

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor me iniciativë ndaj gjyqtarit H.S., pas publikimit të një videoje të realizuar nga emisioni investigativ “STOP”, Televizioni “Klan”, ku gjyqtari H.S. është filmuar në bisedime me një person tjetër, për marrjen me qira të një zyre në pronësi të gjyqtarit. Në dukje rezulton se gjyqtari, duke shfrytëzuar pozicionin e tij të punës, garanton jo vetëm personin e interesuar për të marrë me qira ambientet në pronësi të tij, por shpjegon lehtësitë edhe për subjekte të tjera, avokat a ekspertë, qirramarës në atw godinë.

Gjatë hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar dhe administruar dokumentacion nga ILDKPI, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Nga provat e administruara gjatë hetimit disiplinor ka rezultuar se:

- Në 20 çështje gjyqësore, të cilat gjyqtari i ka gjykuar dhe marrë vendime, avokat i njëjës nga palët kanë qenë qiramarrës në objektin në bashkëpronësi të këtij gjyqtari.
- Në 12 procese gjyqësore të gjykuara nga gjyqtari H.S., ku sipas ligjit kërkohej caktimi kryesisht i avokatit, janë thirrur kryesisht avokatë, të cilët kanë qenë në marrëdhënie kontraktore qiramarrje në ambientet ku gjyqtari është bashkëpronar.
- Në 3 procese gjyqësore, ku prania e ekspertit ishte e nevojshme për zhvillimin e gjykimit, gjykata (gjyqtari H.S.) ka caktuar për ekspert një person në marrëdhënie kontraktore qirramarje me bashkëshorten e gjyqtarit.
- Nga ana e magjistratit janë ndërmarrë veprime që përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës, në shkelje të rregullave të papajtushmërisë, në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe në përdorimin e statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për të tjerët, si dhe në shkelje të parimit të garantimit të besimit të publikut tek drejtësia.
- Është konstatuar mosrespektim në vazhdimësi nga ana e magjistratit e rregullave për t’u shmangur nga konflikti i interesit privat në raport me detyrën e tij zyrtare.
- Është konstatuar përdorimi i statusit të magjistratit me qëllim përfitimi të personave të tretë, nëpërmjet ndikimit për t’i thirrur kryesisht në procese gjyqësore avokatët/ekspertët të cilët janë me qira në pronën në bashkëpronësi të gjyqtarit.

Konkludohet se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit H.S., përbëjnë “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*”, dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen për magjistratin H.S., të masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 111 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.